

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7122
E mërkurë, 21 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

Konjufca: Deklarata e O'Brienit, shqetësuese

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

VJEDHJA E IDENTITETIT F.7

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



HOTI: NË TRI VITET E FUNDIT KA PËRKEQËSIM TË PAPRECEDENT TË STRUKTURËS SË BUXHETIT F.3

KËRKOHEM TË RRIETEDUKIMI PËR SHËNDETIN MENDOR NË SHKOLLA DHE UNIVERSITETE F.7

EKONOMI



35-VJETORI I GREVËS SË MINATORËVE TË "TREPÇËS", KËRKOHEM KUSHTE MË TË MIRA TË PUNËS F.8

KURTI THEKSON PËRKUSHTIMIN PËR TË NDËRTUAR NJË PLATFORMË TË FORTË PËR DIALOGUN PUBLIKO-PRIVAT F.8

SPORT



KUVENDI I FFK-SË, MIRATOHEM RAPORTI I PUNËS DHE AI FINANCIAR

F.10

RAPORTI BRITANIK: RUSIA PO RINDËRTON KAPACITETE PËR TA DESTABILIZUAR EVROPËN, PËRMENDET EDHE KOSOVË

FAQE 4-5



Rusia është duke rindërtuar kapacitete për t'i destabilizuar shtetet evropiane dhe për ta zgjeruar

ndikimin në Lindje të Mesme dhe Afrikë, duke krijuar kështu kërcënim strategjik për NATO-n dhe anëtarët e

saj, të cilët janë të fokusuar te lufta në Ukrainë, vlerëson një institut me bazë në Mbretëri të Bashkuar

TAHIRI: PROPAGANDA E QEVERISË SE KA BËRË NDRYSHIME THELBËSORE NË VERI ËSHTË E PAVËRTETË F.3



ESI: ASNJË VËZHGUES NDËRKOMBËTAR NUK KA PARË 'SPASTRIM ETNIK' TË SERBËVE NË KOSOVË F.7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nëna e Navalnyt i kërkon Putinit t'ia dorëzojë trupin e të birit

SALEHRAD, 20 SHKURT - Nëna e Aleksei Navalnyt, Lyudmila, i ka bërë thirrje presidentit rus, Vladimir Putin, ta lirojë trupin e djalit të saj, i cili ka vdekur më 16 shkurt në një burg në Arktik. Autoritetet ruse kanë refuzuar disa herë ta dorëzojnë trupin e Navalnyt te familja e tij, duke pretenduar se po kryhen "hetime" për ta kuptuar shkakun e vdekjes dhe që procesi mund të zgjasë dy javë. Ato kanë pamundësuar qasjen e nënës dhe avokatëve në morgun në qytetin e Arktikut, Salehrad, ku raportohet se është trupi i Navalnyt. "Mbrapa shpinës sime është burgu IK-3, Ujku Polar, ku ka vdekur djali im Aleksei Navalny, më 16 shkurt", ka thënë Lyudmila Navalnaya përmes një video, kur shihet duke qëndruar në borë, jashtë objektit të rrethuar me gjemba. "Nuk kam mundur të shoh trupin e tij për pesë ditë. Nuk ma kanë dorëzuar dhe nuk më kanë treguar se ku është", ka thënë Navalnaya, duke iu drejtuar Putinit me emër, pa iu referuar si president.

"Po të them ty, Vladimir Putin, sepse zgjidhja e këtij problemi varet vetëm prej teje. Më lejoni ta shoh djalin tim. Kërkoj që trupi i Alekseit të lirohet menjëherë, që të mund të varrosët në mënyrë njerëzore", ka thënë Navalnaya.

Gati 70 000 qytetarë rusë kanë dërguar kërkesë zyrtare te Komiteti Hulumtues i Rusisë, që trupi i Navalnyt t'i dërgohet familjes.

Teksa rritet zemërimi për shkak të refuzimit të autoriteteve dhe spekulimeve për shkakun e vdekjes së Navalnyt, e veja e tij, Yulia Navalnaya, ka pretenduar se autoritetet ruse janë duke shtyrë afatin e dorëzimit të trupit, derisa të zhduken gjurmët e helmimit të tij me Novichok.

E veja e kritikut të Kremlinit ia ka vënë fajin Putinit për vdekjen e burrit të saj dhe është zotuar se do ta vazhdojë luftën kundër Kremlinit dhe do të sigurohet që të ndëshkohen fajtorët.

Kremlini e ka konsideruar 'vulgare dhe të pabazuar'



akuzën e Yulias.

Llogaria e saj është pezulluar për pak kohë në platformën "X".

Ajo e ka hapur llogarinë më 19 shkurt, tri ditë pas vdekjes së burrit të saj.

Bashkimi Evropian ka kërkuar hetim të pavarur për shkakun e vdekjes së Navalnyt.

Navalny është një tjetër person në listën e kundërshtarëve të Putinit që kanë vdekur nën rrethana të

dyshimta në Rusi, ose jashtë saj. Prej kur është bërë me dije lajmi për vdekjen e tij, policia e Rusisë ka arrestuar më shumë se 430 persona që kanë kryer homazhe për Navalnyn.

Pas opozitës shqiptare, edhe BDI-ja me kandidat për president të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 20 SHKURT - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) do të marrë pjesë në garën për president të Maqedonisë së Veriut, por kryetari i kësaj partie, Ali Ahmeti, nuk do të jetë kandidat për president, kështu bën me dije nga BDI-ja, duke komentuar njoftimet se drejtuesi i saj do të jetë një nga kandidatët në zgjedhjet për kreun e shtetit. Zgjedhjet për president të Maqedonisë së Veriut do të mbahen në dy runde: i pari më 24 prill, raundi i dytë do të mbahet së bashku me zgjedhjet parlamentare më 8 maj. Kryeministri teknik Talat Xhaferi tha të martën, më 20 shkurt, se nuk mendon se Ali Ahmeti do ta pranonte kandidaturën për president pasi "ai (Ali Ahmeti) ka për mision Bashkimin Evropian dhe po punon për këtë mision". Ai nuk ka nevojë të tregojë se kush është dhe sa ka kontribuar për këtë vend dhe për qytetarët e këtij vendi. Nuk mendoj se është prioritet për të që të konkurrojnë për ndonjë pozicion [pozitë]. Sikur të donte, ai mund të kishte cilëndo pozitë në shtet në këto 22 vjet", deklaroi Xhaferi, i cili është anëtar i kryesisë së BDI-së. Zëvendëskryeministri Artan Grubi nëpërmjet rrjeteve sociale bëri me dije se Ahmeti se shpejt do të dalë me "lajmin e madh",



por pa saktësuar nëse do të paraqitet ndonjë kandidat tjetër për president.

Grubi tha për mediet se "anëtarësia e BDI-së është për kandidaturën e Ali Ahmetit" por Ahmeti, sipas tij, parapëlqen të punojë për "mision dhe jo për funksion".

Jozyrtarisht një nga emrat që përfillet në opinion është edhe ai

i ministrit të Punëve të Jashtme, Bujar Osmani.

Ndërkohë, me daljen eventuale të BDI-së me kandidat për president, bie poshtë paralajmërimi i Lidhjes Social Demokrate (LSDM) se partitë në pushtet do të dalin me një kandidat presidencial të përbashkët.

Kryetari i LSDM-së, Dimitar

Kovaçevski, tha se kjo parti në zgjedhje do të marrë pjesë ma kandidatit e saj, që beson se do të jetë i pranueshëm për të gjithë qytetarët. "Ne kemi kandidat që i përmbush të gjitha kriteret për të qenë përfaqësues i të gjithë qytetarëve, personalitete që ndajnë vlerat evropiane, që angazhohen për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian",

tha Kovaçevski duke mos përjashtuar mundësinë e kandidaturës së presidentit aktual Stevo Pendarovski.

Kandidaturat për president deri tani i ka publikuar vetëm opozita e bashkuar shqiptare, e cila do të garojë me Arben Taravarin dhe partia E Majta, me Biljana Vankovskën.

Kandidati i opozitës shqiptare ka mbështetjen edhe të Lëvizjes Vetëvendosje që drejtohet nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Bekim Qoku, këshilltar i Kurtit, ka nënshkruar deklaratën e opozitës së bashkuar shqiptare për pjesëmarrje të përbashkët edhe për zgjedhjet parlamentare më 8 maj.

Opozita maqedonase e udhëhequr nga VMRO DPMNE-ja tha se kandidatit e saj do ta bëjë të ditur në konventën partiake më 2 mars.

Afati për shpalljen e kandidaturave për president skadon më 19 mars.

Kandidatët mund të propozohen në Kuvend nga 30 deputetë apo të mbledhin nga 10 mijë nënshkrime të qytetarëve. Vetëm LSDM-ja dhe VMRO DPMNE-ja nuk kanë nevojë për nënshkrim pasi në Kuvend janë të përfaqësuara me nga më shumë se 30 deputetë.

Mot pranveror në mes të shkurtit nëpër Ballkan

PRISHTINË, 20 SHKURT - Nga Spanja deri në Poloni, një valë e të ngrohtit - jo e zakonshme për muajin shkurt - preku Evropën, përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto ditë të ngrohta e me diell mbushën sheshet plot me njerëz që po i shijonin rrezet e diellit, raporton REL.

Moti i ngrohtë në mes të muajit shkurt që përfshiu një

pjesë të Evropës solli temperatura të larta edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Moti i ngrohtë e me diell vazhdoi edhe gjatë vikendit që shkoi, më 17 e 18 shkurt. Shumë qytetarë kishin dalë nëpër sheshet e Prishtinës për ta shënuar 17 Shkurtin e vitit 2008 - Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Qytetarë të shumtë që kishin

dalë për ta festuar 16-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës po shijonin motin e ngrohtë pranë Obeliskut të Pavarësisë, "Newborn", në Prishtinë.

Temperaturat e larta kanë vazhduar edhe në mesin e muajit shkurt, ndërsa mbi 15 gradë janë shënuar edhe në pjesët kontinentale, Mal të Zi, Dobra Voda, Komuna e Tivarit.



Vetëm 85 kilometra larg nga rajonit, ka pak borë për shkak të temperaturave të larta.

Tahiri: Propaganda e qeverisë se ka bërë ndryshime thelbësore në veri është e pavërtetë

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se qeveria Kurti po bën propagandë për ndryshime thelbësore në veri të vendit. Tahiri thotë se veriu është pa sovranitet e me protektorat të shtuar. Sipas saj, forcat e KFOR-it po shtohen çdo ditë.

Tahiri ka theksuar se në veri nuk funksionojnë gjykatat e Kosovës, nuk funksionojnë katër komunat, nuk paguhet rryma, madje as faturat e rrymës nuk u kanë shkruar qytetarëve. "Veriu pa sovranitetin e shtetit plus me protektorat të shtuar,

forcat e KFOR-it çdo ditë po shtohen në veri - propaganda e qeverisë se ka bërë ndryshime thelbësore në veri janë të pavërteta. Në veri nuk funksionojnë gjykatat e Kosovës, nuk funksionojnë katër komunat, nuk paguhet rryma, madje as faturat e rrymës nuk i kanë shkruar qytetarëve. I vetmi institucion që funksiononin është Policia e Kosovës por pa policët serbë. Ne qeveritë e kaluara e shtrim sovranitetin në veri, i vendosëm të gjitha institucionet e shtetit në veri, e vendosëm kufirin me Serbinë, madje shënuam dhe pikat kufitare", ka shkruar Tahiri në "Facebook".



Hoti: Në tri vitet e fundit ka përkeqësim të paprecedent të strukturës së buxhetit



PRISHTINË, 20 SHKURT - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se në tri vitet e fundit ka përkeqësim të paprecedent të strukturës së buxhetit, ndërsa ka theksuar se "kjo politike buxhetore nuk siguron zhvillim". Sipas tij, gjatë kësaj periudhe trefish më shumë po shpenzohet në subvencione-transfere sesa në ndërtimin e rrugëve, shkollave, spitaleve apo në pajisje të ushtrisë e policisë. "Përkeqësim i paprecedent i

strukturës së buxhetit në tri vitet e fundit: Trefish më shumë shpenzohet në subvencione-transfere se në ndërtimin e rrugëve, shkollave, spitaleve apo në pajisje të ushtrisë e policisë. Kjo politikë buxhetore nuk siguron zhvillim. As varfëria nuk eliminohet kështu. Ajo mund të zbutet përkohësisht me subvencione, por eliminohet vetëm me zhvillim. Më tepër është investuar në 2 vite e 9 muaj të Qeverinë Mustafa (979 milionë

euro shpenzimet kapitale në nivelin qendror), se në Qeverinë aktuale që është në vitin e katërt të mandatit (910 milionë euro shpenzimet kapitale në nivelin qendror). Për më tepër, në Qeverinë Mustafa 20 për qind e buxhetit është dedikuar për shpenzime kapitale të nivelit qendror. Ndërkaq, në Qeverinë aktuale, shpenzimet kapitale të nivelit qendror kanë rënë në 12 për qind të buxhetit", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Sibel Halimi emërohet drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës në Prishtinë

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se Sibel Halimi është emëruar drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës në Prishtinë. "Me shumë kënaqësi e përgjegjësi Sibeli e ka marrë detyrën e re për ta vazhduar misionin tonë për një kryeqytet me jetë të pasur kulturore e artistike. Znj. Halimi është duke doktoruar në Departamentin e Sociologjisë të Universitetit të Prishtinës me temën "Trupi si

konstrukt shoqëror: Drejt sociologjisë së trupit në Kosovë", ka shkruar Rama në "Facebook".

Kryetari i Prishtinës ka theksuar se që nga viti 2004 Sibeli merret aktivisht me studime dhe kërkime shkencore në fushën e studimeve gjinore dhe sociologjisë, duke trajtuar problemet socio-filozofike. "Prej vitit 2014-2018 ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtoresh e jashtme në Departamentin e Filozofisë dhe atë të

Sociologjisë të Universitetit të Prishtinës, si dhe për dy mandate ishte anëtare e Kryesisë së Shoqatës së Filozofëve të Kosovës. Sibeli i uroj mirëseardhje dhe punë të mbarë në detyrën e saj të re. Jam i bindur se përvoja dhe përkushtimi i saj do të nxjerrin në pah potencialin e madh dhe pasurinë e shpirtit artistik të Prishtinës", ka thënë Rama. Po të martën Rama ka emëruar Donjeta Dragushën drejtoreshë të Drejtorisë për Zhvillim Rural.





Rusia po rindërton kapacitete për ta destabilizuar Evropën, thotë një raport britanik, përmendet edhe Kosova

PRISHTINË, 20 SHKURT - Rusia është duke rindërtuar kapacitete për t'i destabilizuar shtetet evropiane dhe për ta zgjeruar ndikimin në Lindje të Mesme dhe Afrikë, duke krijuar kështu kërcënim strategjik për NATO-n dhe anëtarët e saj, të cilët janë të fokusuar te lufta në Ukrainë, vlerëson një institut me bazë në Mbretëri të Bashkuar.

Hulumtuesit e Institutit Royal United Services [RUSI] kanë argumentuar se kombet perëndimore duhet të bëjnë më shumë për ta luftuar Moskën dhe taktikat e saj të një lufte jokonvencionale, nëse dëshirojnë të kenë sukses në mposhtjen e Rusisë në Ukrainë. "Përderisa lufta në Ukrainë po zgjatet, Rusia ka interes të krijojë kriza përtej", kanë thënë autorët Jack Watling, Oleksandr V. Danylyuk dhe Nick Reynolds, duke e përmendur edhe Ballkanin si rajon të njohur tashmë për kryerje të këtyre veprimeve të liga. "Rusia ka interes edhe në destabilizim të

partnerëve të Ukrainës dhe me ofrimin e zgjedhjeve nëpër Evropë, ekzistojnë një mori mundësish për t'i rritur ndasitë", kanë thënë autorët.

Raporti prej 35-faqesh nga ky institut, i themeluar më 1831, është publikuar më 20 shkurt, vetëm disa ditë para përvjetorit të dytë të nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë. Meqenëse përpjekjet ruse për t'i destabilizuar shtetet sikurse Moldavia kanë dështuar, kryesisht për dëbimin masiv të operativëve të Kremlinit, ushtria ruse është duke i forcuar kapacitetet për të lansuar sulme jokonvencionale, është thënë në raport.

Duke i përdorur dokumentet e siguruar prej shërbimeve

sekrete ruse dhe intervistave me zyrtarë në Ukrainë, dhe në disa shtete evropiane, në raport vihet në pah narrativa ruse për ta zgjeruar ndikimin përtej konfliktit në Ukrainë.

Pse përmendet Kosova në raport?

Mes të tjerash, në raport përmendet edhe se si shtrirja e ndikimit bëhet, po ashtu, përmes shoqatave të ndryshme bamirëse, e një ndër to është Fondacioni Ahmet Kadyrov, i cili tenton ta popullarizojë Kadyrovin si figurë fetare. Punë të ngjashme bën edhe entiteti Forumi Islamik Evropian. "Organizata është

sidomos aktive në Ballkan, ku ka krijuar lidhje me përfaqësues autoritarë myslimanë (jo vetëm fetarë, po edhe figura politike) në Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Kroaci, Greqi dhe Rumani".

Në korrik të vitit 2021 në Bashkësinë Islame të Kosovës dhe në Fakultetin e Shkencave Islame ka qëndruar për vizitë një delegacion nga Forumi Mysliman Evropian (EMF), i kryesuar nga kryetari i tij Abdul-Wahed Niyazov.

Delegacionin e Forumit Mysliman Evropian e kishte pritur në takim myftiu Naim Tërnavë, kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe bashkëpunëtorët e tij, por ata nuk e kishin shqyrtuar gjatë se çfarë paraqiste ky forum dhe kush ishte drejtuesi i tij, Abdul-Wahed Niyazov.

Forumit Mysliman Evropian është organizatë që ka selinë në Bruksel dhe është themeluar në tetor të vitit 2018.

Disa nga qëllimet e këtij Forumi,

të cekura në faqen e tij të internetit, janë: integrimi i migrantëve myslimanë në shoqërinë evropiane, ndihma për ndërtimin dhe zhvillimin e xhamive dhe qendrave kulturore islamike në vendet evropiane, organizimi i aktiviteteve që synojnë popullarizimin e trashëgimisë kulturore islame evropiane, zhvillimi i projekteve arsimore në internet për të arritur një audiencë më të gjerë nga të rinjtë myslimanë, zhvillimin e industrisë hallall në vendet evropiane etj.

Drejtuuesi i Forumit, Niyazov, kryeson gjithashtu Qendrën Kulturore Islamike të Moskës, një departament publik i këshillit zyrtar të myftiut rus dhe gjithashtu organ i lidhur me Kremlinin.

Në Federatën Ruse, Niyazov konsiderohet bashkëpunëtor i afërt i presidentit rus Vladimir Putin, i cili prej vitit 1999 e deri në vitin 2003 ka qenë përfaqësues i partisë së Putinit në Dumën ruse. (REL)

Çfarë është RUSI?

Royal United Services është instituti më i vjetër në botë dhe kryesori në Mbretëri të Bashkuar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Misioni i tij është informimi dhe përmirësimi i debatit publik për të ndihmuar në ndërtimin e një bote më të sigurt dhe më stabile. Selia e institutit është në Londër.

Në Leposaviq kapen mallra të kontrabanduara në vlerë prej 5 000 eurosh

LEPOSAVIQ, 20 SHKURT - Në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, Njësitë Antikontrabandë të Doganës së Kosovës kanë arritur një sukses të rëndësishëm në luftën kundër kontrabandës

dhe aktiviteteve të paligjshme të tregtisë. "Pas një operacioni të koordinuar është ndaluar një automjet i dyshimtë në territorin e Kosovës, i cili kishte hyrë në vend përmes rrugëve ilegale. Automjeti në

fjalë, në përputhje me dyshimet tona, ishte duke transportuar mallra të kontrabanduara, kryesisht mallra ushqimore. Vlera e mallit të kapur është mbi 5 000.00 euro. Ky sukses është

një dëshmi e qartë e përpjekjeve të vazhdueshme të njëjësive Doganës dhe Policisë së Kosovës për ta luftuar krimin e organizuar dhe tregtinë e paligjshme", ka njoftuar Dogana e Kosovës.



Konjufca: Deklarata e O'Brienit, shqetësuese

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, e ka komentuar deklaratën e zëvendëssekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, i cili tha se nëse ShBA-ja nuk trajtohet si partnere nga Kosova, njëjtë do të veprojnë edhe Amerika karshi Kosovës.

Konjufca tha se deklarata e O'Brienit ishte shqetësuese por, sipas tij, duhet shtruar pyetja se pse dinari serb "po e prishka relacionin e Kosovës me ShBA-në". "Ata po thonë që përmes

këtyre veprimeve po na befasoni. E partneriteti është mos me u befasu. Nëse dinari hiqet ashtu, serbët u çuan në protestë dhe ajo mund të shkaktojë tensione. Tash tensionet e rrezikojnë sigurinë e Kosovës dhe nëse cenohet siguria, mund të vijë deri te dalja jashtë kontrollit. E kur del situata jashtë kontrollit, përgjegjësinë më të madhe e merr Amerika për ta ndalë dhe për ta kthyer situatën në binarë", tha Konjufca për "Demos".

Më tutje kreu i Kuvendit tha se

Kosova e kupton pse ShBA-ja është hidhëruar dhe, sipas tij, [Amerika] gjithmonë e sheh këtë prej perspektivës së sigurisë. "Ne dimë prej Jugosllavisë, që situata kur del shumë prej kontrollit, Evropa s'ka mundur ta kthejë në binarë. Ne e kuptojmë pse ata janë hidhëruar. Gjithmonë e shohim këtë prej perspektivës së sigurisë. Qëllimi ynë është ta kuptojnë në mënyrën më të mirë të mundshme se cili është kufiri mes disa detyrave tona të shtëpisë sonë që ne duhet t'i bëjmë

patjetër dhe cilat janë ato të cilat asnjë nuk duhet bërë pa pyet", ka thënë ai.

Ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka deklaruar se vendimi i autoriteteve të Kosovës për ndalimin e dinarit serb ka ndikuar në cilësinë e raporteve në mes të dy shteteve. Në një konferencë për medie ai ka thënë se deklaratat e zyrtarëve amerikanë kanë qenë vazhdimisht të qarta se Kosova duhet ta shtyjë vendimin e zbatimit të rregullores së BQK-së.

Hovenieri ka theksuar se ndihet i shqetësuar nga deklaratat publike të kryeministrit Kurti dhe zyrtarëve të tjerë të pushtetit pas intervistës së O'Brienit, të cilët pretenduan se partneriteti ShBA - Kosovë nuk është prekur dhe mund të mos preket nga kjo situatë, duke shtuar se "duhet të jem i qartë se kjo nuk është aspak e vërtetë. Nuk është kështu". Në këtë drejtim ai ka thënë se është "gjë e rrallë" që Kosova të kritikohet nga ShBA-ja në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.



Ngrehet aktakuzë ndaj 14 zyrtarëve policorë për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm

PRISHTINË, 20 SHKURT - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se Prokurori i Shtetit, pas zhvillimit të hetimeve, mbledhjes dhe analizimit të provave, ka ngritur aktakuzë ndaj katërmëdhjetë zyrtarëve policorë, të përfshirë në rastin e datës 18.02.2022, në fshatin Zllatar të Prishtinës.

Sipas aktakuzës, të pandehurit F. A., E. I., B. M., E. Th. dhe G. T., më 18.02.2022, rreth orës 22:00, në fshatin Zllatar të Prishtinës, në një vilë në këtë fshat, në të cilën kishin organizuar një aheng privat, jashtë detyrës zyrtare kanë vepruar në kundërshtim me rregullat për autorizimet e policisë



dhe përdorimin e armës të paraparë në Ligjin për Policinë, në atë mënyrë që në zhvillim e sipër të ahengut, kanë shtënë me armë

zyrtare duke përdorur municion jozyrtar, gjersa ishin në terracën e vilës ku zhvillohej ahengu. Me këtë, secili prej tyre individualisht

e kanë kryer veprën penale "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm", nga neni 367, paragrafi 1 i KPRK-së, në lidhje me nenin 11, paragrafi 5 dhe nenin 27, paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, në fuqi në Republikën e Kosovës.

Të pandehurit F. A., E. I., B. M., E. Th. dhe G. T., në datën, vendin dhe kohën e lartcekur, si dhe për arsye të njëjta, gjatë përdorimit të armës, në kundërshtim me ligjin, kanë shkaktuar rrezik të madh për jetën e personave të pranishëm, andaj me këtë kanë kryer veprën penale "Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm" nga neni 356, paragrafi 1 i KPRK-së.

Ndërsa të pandehurit A. B., Xh. B., A. M., A. A., A. Z., I. S., Rr. A., V. Rr. dhe A. M. nuk i kanë lajmëruar veprat penale të lartcekura, në atë mënyrë që nuk i kanë raportuar të shtënë me armë zjarri të bëra nga kolegët e tyre - të pandehurit gjatë ahengut ku kanë qëndruar së bashku, andaj me këtë kanë kryer veprën penale "Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre", nga neni 378, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 i KPRK-së.

Prokurori i Shtetit me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

VJEDHJA E IDENTITETIT



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kush do ta mbrojë Kosovën: Për shënimin e 16-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës institucionet kryesore të vendit kishin bërë gati një program që dallonte nga vitet paraprake sikur që e kishin përgatitur një poster ku, midis të tjerash, ishte një zotim se: "ne të dalim zot, Kosovë..." duke nënkuptuar se "dalëzotësit ishin kryeministri Albin Kurti, presidentja Vjosa Osmani dhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, në krye të një ushtrie virtuale me qindra dhe mijëra luftëtarë anekënd botës që luftën e bëjnë kryesisht nga profilet e rrejshme. Këtyre luftëtarëve iu bashkëngjiten edhe patriotët e dëshmuar për lirinë e Kazakistanit si Dimali, Donika Shvarci, Mefi, Hekuran Teneqja, Kaçketë Dezertori, Cen Ikanaku, Rozeta e Panxhabit, Bekim Kocja (si përforcim nga Maqedonia e Veriut), "rogëtarët e Luginës" në krye me komisararin politik të gatshëm për çdo sakrificë kur është afër fundeve të ndonjë ministre, Besnik Hiçmosgjëja. Në prapavijë e keni Jeton Qurroin, strategun e njohur që nga koha e ish-Jugosllavisë, i gatshëm të bëjë gjënë e duhur e që asnjëherë nuk i ka shërbyer popullit shqiptar apo Kosovës përveçse në emër të këtyre "idealeve" ka vjel miliona e miliona euro, pa e vënë në rrezik as fijen e flokut. Paraardhësit e tyre biologjikë (jo të gjithëve), por edhe të atyre që sot janë aziluar, duke bërë shtatë palë qejfe në LV, ua kanë lënë amanet që kurrë mos ta harrojnë mëmën... Jugosllavi dhe Serbi, kurse njerëz Kosovë ta përdorin për rrefreskim të këtij amaneti. Duhet të jeni së paku pacientë në baza të rregullta te Nexhmedin Shala e të besoni se të lartcekurit dhe ata që shkojnë pas tyre do ta bënin edhe sakrificën më të vogël për Kosovën. Do të sakrifikonin aq sa kanë sakrifikuar paraardhësit e tyre biologjikë dhe politikë duke mos bërë asgjë! Ose, duke i shërbyer atyre që po e rrezikojnë sigurinë e Kosovës. Nuk ka asnjë mëdyshje se kundërshtimin, qoftë edhe me jetë në mbrojtje të Kosovës, Shqipërisë dhe shqiptarëve, kudo që jetojnë do ta bëjnë ata që lanë asht e rrashtë për Kosovën, Shqipërinë dhe shqiptarinë. Nëse jo ata që për shkak të moshës së madhe nuk do

të jenë në gjendje ta bëjnë këtë, sipas parimit se dardha bie nën dardhë, këtë do ta bënin pasardhësit e tyre biologjikë të sistemuar në Policinë e Kosovës, Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe institucionet tjera të vendit. Do ta bënin sepse e kanë kodin gjenetik të trashëguar nga ata që në rrethana të jashtëzakonshme e bënë luftën për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar e që asnjëherë nuk kanë pasur nënë tjetër përveç Nënës Shqipëri. Sakrifika antologjike e Komandantit Legjendar Adem Jashari, bashkë me familje që i kishte edhe bashkëluftëtarë, e familjes Haradinaj, Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, Zahir Pajazitit, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Remzi Ademajt, doktor Hafir Shalës dhe Xhevat Hazirit, Agim Ramadanit dhe Sali Çekut dhe heronjve të tjerë të kombit si dhe martirëve, veteranëve të së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, invalidëve të luftës që gjymtyrët dhe shëndetin e lanë si garantues kundër robërisë, ish të burgosurve politikë që kaluan tmerre nëpër llogoret e ish Jugosllavisë e që u torturuan nga paraardhësit e një numri të "kuadrove" të LV-së sikur edhe trashëgimia kombëtare, politike dhe ushtarake e pengjeve që po mbahen në Hagë, me kontribut shumë domethënës të disave që mbajnë poste të larta në Kosovë, janë garantues se ka kush ta mbrojë Kosovën kurse këta që virtualisht dhe mediatisht deklarohen se: "do ta mbrojnë Kosovën..." "këtë, pa asnjë dyshim do ta bënin nga një distancë e sigurisë së plotë për ta dhe familjet e tyre nga Australia, ShBA, Norvegjia, Gjermania, Zvicra, Franca, Italia, Turqia, Izraeli dhe, disa, për shkak të meritave, pa asnjë dyshim do të luftonin nga Serbia. Mos e dhashtë Zoti të ketë luftë në Kosovë se ...se ..., këta "dalzotës" të Kosovës do të vepronin si mbreti Zog që shpejt e shpejt mori rrugën për Greqi, Egjipt, Francë dhe Afrikë të Jugut, jo për të luftuar por për ta bërë "trush dhe kumbulla" pasurinë e shqiptarëve. Dhe, së fundi, Kosovës, Shqipërisë dhe shqiptarisë i dalin zot ata që e mësuhan abetaren kombëtare dhe politike të të Përjetshmit, Bacë Adem Demaçi për ta vazhduar shkollimin, deri në nivelet akademike në llogoret e ish-

Jugosllavisë, që nga Goli Otoku, Stara Gradishka dhe Lepoglava, Zenica dhe Foça, Zabella, Pozharevci dhe Nishi e deri te Spuzhi dhe Idrizova, llogore ku qëndruan ata që luftuan dhe, në një pjesë të tyre edhe takuan Kuptimin për Liri, Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar, Bacë Adem Demaçi.

Nuk rishkruhet historia në rrethana të histerisë: Gjykata Raciste Speciale në Hagë, me arrestimin, gjykimin dhe dënimin e kreut ushtarak të UÇK-së si dhe bartësve më të lartë të posteve shtetërore në Kosovën e pasluftës (presidenti Hashim Thaçi, kryetarëve e Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, shefit të GP të LV-së, Rexhep Selimi), pastaj të drejtuesve të Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, Salih Mustafës, Pjetër Shalës dhe "penguesve të drejtësisë", për qëllim të deligjitimit të luftës e fundit në Kosovë e udhëhequr nga UÇK-ja, relativizimin e krimeve të Serbisë, baraspeshimin e përgjegjësiave po i përdorë si mjet për arritjen e qëllimit final; rishkrimin e historisë si dhe kundërshtimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës përmes kriminalizimit të luftës dhe udhëheqësve më të lartë të saj që tani, ose janë dënuar ose janë në proces të gjykitimit. Në prag të shënimin të 16-vjetorit të pavarësisë së Kosovës pati përpjekje të rishkruhet historia e re e Kosovës duke huazuar diçka edhe nga Gjykata Speciale Raciste e Hagës. Sot në Kosovë kemi Albin Kurtin kryeministër, personalitet me fuqinë e Zeusit, sidomos për vartësit e tij. Albin Kurti, mund edhe të mos pajtohet me mua e disa shokë, ka një histori si pjesë e stafit të Zyrës së UÇK-së në Prishtinë të Bacës Adem Demaçi, si udhëheqës i protestave studentore, si i burgosur politik në Serbi pasi u mor si rob lufte dhe për shkak të qëndrimit të drejtë dhe të fortë, si para gjykatës në Nish, ashtu edhe gjatë vuajtjes së dënimit. Kishte qëndrim të drejtë dhe parimor edhe për Konferencën e Rambujesë. Pas përfundimit të luftës ishte i afërt me Bacën Adem deri në çastin kur u "pavarësua" dhe i pengonte ombrella kombëtare dhe politike e Bacës.

Këtu edhe filloi theqafja e Albinit të dikurshëm dhe shfaqja e Albinit në një rol tjetër, marrja e pushtetit me çdo kusht dhe me të gjitha mjetet duke kombinuar metodat e "Të Urtëve të Sionit", Nikollo Makiavellit dhe Klauzevicit. Madje, ua kaloi që të treve në luftë për pushtet duke i bërë të duken karikatura. Vjosa Osmani u bë presidente, pa asnjë të kaluar dhe pa asnjë meritë. U bë presidente falë vullnetit të Zeusit, Albin Kurtit. E tashmja e saj mbështetet në filozofinë politike të Sellmës dhe të Valdrinit dhe fleksibilitetit, deri në dorëzim, pa asnjë kusht ndaj Albinit. Karrierën politike aktuale e ka si notere e Albinit Kurtit. Në planin ndërkombëtar, si këshilltare politike dhe ushtarake e Zellenskit dështoi keq. Po vepron si të ishte motra e Cezare Borxhias duke helmuar mjedisin ku vepron. Glauk Konjufca, me një emër ilir dhe mbiemër aspak shqiptar, për shkak të moshës nuk ka pasur të kaluar të lavdishme çlirimtare për dallim nga babai që ishte i burgosur politik. E tashmja e Glaukut do të mbahet mend si shërbyes civil i Albinit Kurtit. E ardhmja, çfarë do të jetë e ardhmja, mashtrues i imtë apo pendues i madh. Por duhet ta pranojmë një cilësi që e ka, oportunist e shkuar oportunistit. Një ditë para festës zyrtare Qeveria e Kosovës kishte bërë gati një spot promovues për ditën e pavarësisë, sa mashtrues aq edhe përjashtues. Aty, në rolin e Azem Bejtës dhe Shotë Galicës ishin Albini dhe Vjosa. Baca Adem Demaçi si dhe Hashim Thaçi nuk ishin askund, madje as si hijezim i sfondit ku "shkëlqenin" dyshja politike e njohur si Boni dhe Klajd. Ishte Komandanti Legjendar Adem Jashari, jo se e nderojnë apo e respektojnë por se manipulojnë me të. Krijohet përshtypja se pavarësia e Kosovës u shpall atë ditë dhe se historia gjithashtu u shkrua atë ditë, me protagonistë tjerë. Çdo gjë para kësaj dite u retushua. Çfarë veprimi mizor dhe çfarë shkelje brutale e historisë! Të nesërmen, në seancën solemne në Kuvendin e Kosovës, KM Kurti e bëri një përmirësim të rishkrimit të historisë duke përmendur edhe emrat e Bacës Adem Demaçi, presidentit Thaçi dhe Rugovës. Realisht, ua njohu rolin teknik, sidomos presidentit Thaçi. Tha se

Hashim Thaçi e ka lexuar Deklaratën e Pavarësisë dhe se e ka nënshkruar duke bërë përpjekje të asgjësojë rolin e Hashim Thaçit si akterit kryesor për pavarësimin e Kosovës, që nga angazhimi i tij politik para lufte, pjesëmarrjes së tij në luftën çlirimtare, njeriun kryesor në Konferencën e Rambujesë, kryesori në bisedimet e Vjenës dhe, pa asnjë dyshim, i pari në mesin e më të merituarve për pavarësinë e Kosovës. Realisht, gjithmonë kam menduar, ashtu mendoj edhe sot se njeriu më meritor dhe më i përshtatshëm për ta lexuar Deklaratën e Pavarësisë, prej të gjallëve që kishte krijuar dhe mbronte veprat e krijuara ishte Bacë Adem Demaçi. Kështu do të duhej të mendonte dhe vepronte edhe Hashim Thaçi mirëpo ai mendoi ndryshe dhe veprimi ndryshe. Pastaj, pasi Baca Adem Demaçi nuk u lejua ta bëjë këtë, pa asnjë dyshim se Hashim Thaçi ishte ai që duhej ta lexonte këtë deklaratë dhe asnjëri tjetër. Nga aspekti kombëtar, politik dhe pragmatik do të ishte e palejueshme që këtë Deklaratë ta lexojë dikush që asgjë nuk ka bërë për luftën dhe që deri dje ka qenë pjesë e institucioneve represive të Jugosllavisë. Në aspektin njerëzor, kombëtar dhe moral askush tjetër nuk duhej të ishte në foltore të kuvendit të Kosovës përveç Bacë Adem Demaçit. Shihe ti çfarë leshkoje jam, e përmendi aspektin njerëzor dhe moral! Për mua nuk paraqet problem pse Hashim Thaçi e ka lexuar dhe nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë por pse atë Deklaratë e kanë nënshkruar bashkëpunëtorët e djeshëm të Jugosllavisë dhe Serbisë duke u rehabilituar për një veprimtari antikombëtare! Kufiri midis marrëzisë dhe lavdisë është sa një fije peri prandaj nuk është aspak lehtë ta kuptoni se ku dhe kur përfundon lavdia dhe ku dhe kur fillon marrëzia. Albin Kurti le të merret me retorikë, i shkon, mos të merret me histori sepse dështon. Kësaj radhe ka shpëtuar para ligjit shkak se për pesë minuta deshi ta merr një identitet tjetër...identitetin e Hashim Thaçit dhe, pasi ta ketë lexuar Deklaratën e Pavarësisë të bëhet përsëri Albin Kurti. Fort e çuditshme kjo për mua, e pakuqtueshme!

Kërkohej të rritet edukimi për shëndetin mendor në shkolla dhe universitete

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHKURT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) dhe Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë kanë nisur të martën konferencën dyditore "Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës".

Në këtë konferencë morën pjesë edhe pjesëmarrës dhe drejtues të

lartë të Qendrës së Solidaritetit me seli në Uashington DC të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i ka falënderuar të pranishmit për këtë konferencë, me ç'rast ka thënë se konferenca e sotme dëshmon një front të përbashkët të angazhimeve në shërbim të arsimit. "Jemi të nderuar që përfaqësuesit e këtyre sindikatave simotra, bashkë me përfaqësueset e sindikatës nga

Slovenia, janë bashkë me ne në këtë aktivitetet dhe dua t'i falënderoj. Kjo konferencë dëshmon se bashkërisht e duke krijuar një front të përbashkët të angazhimeve në shërbim të arsimit, mund të ndihmojmë në ndryshimet për të mirën e një shkolle e për një arsim më cilësor", ka deklaruar Jasharaj.

Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atdhe Hykollli, e konsideroi thelbësore këtë konferencë dhe shpreston që të

përdoret për ndryshimin dhe zhvillimin e shkollave në vend. "Sot jemi mbledhur në angazhim të përbashkët për të diskutuar për shëndetin mendor. Kjo temë është në kohën e duhur dhe thelbësore për shkak të rëndësisë që ka adresimi i shëndetit tonë mendor dhe nuk është vetëm detyrim, por është obligim i komunitetit tonë. Shpresojmë që këto diskutime të na dërgojnë në zhvillimin e shkollave dhe ta përdorim këtë konferencë si

një katalizator për ndryshimin dhe zhvillimin e shkollave tona", ka deklaruar Hykollli.

Kryetarja e Odës së Infermierëve të Kosovës, Nexhmije Gori, ka kërkuar nga institucionet të rritin edukimin për shëndetin mendor në shkolla dhe universitete. Ajo ka thënë se shpeshherë keqkuptimet në çështjet e shëndetit mendor i bëjnë njerëzit të vuajnë në heshtje dhe nuk kërkojnë trajtim për vështirësitë e tyre.

ESI: Asnjë vëzhgues ndërkombëtar nuk ka parë 'spastrim etnik' të serbëve në Kosovë



PRISHTINË, 20 SHKURT - Nisma Evropiane për Stabilitet tha se asnjë organizatë ndërkombëtare, përfshirë ato të sigurisë, nuk ka parë prova për pretendimet e Beogradit se në Kosovë ka "spastrim etnik të serbëve", po mungesa e provave nuk u ka dhënë fund pretendimeve nxitëse.

Në një raport me titullin "Pogromet e sajua - statistikat, gënjeshtrat dhe konfuzioni në Kosovë", organizata kujton se në korrik të vitit 2023 presidenti serb Aleksandar Vuçiq deklaroi NATO-ja dhe OKB-ja kishin katërmbëdhjetë ditë për t'i çarmatosur forcat policore të Kosovës dhe për t'i mbrojtur

serbët e Kosovës nga "pogromet dhe spastrimi etnik" i vazhdueshëm i shqiptarëve. Përndryshe, "dikush tjetër" do të duhej ta bënte këtë.

Raporti vë re se paralajmërimet se Serbia mund të ketë nevojë të dërgojë trupa në Kosovë për t'i mbrojtur serbët nuk janë të reja, duke iu referuar një deklaratë të presidentit serb Vuçiq të gushtit të vitit 2018, në të cilën e kishte përshkruar Kosovën si një fuçi baruti. "Të gjithë do të presin një mundësi për ta goditur tjetrin për të arritur një avantazh në terren. Dhe çdo ditë do të shqetësohemi nëse do të na sulmojnë në veri, ku do të na godasin, me mbështetjen e kujt...", kishte thënë president

serb. Mirëpo në deklaratat e vitit 2018 argumentohej se nëse serbët sulmohen në Kosovë, Serbia do t'i mbrojë ata. Që nga viti 2023 deklaratat argumentojnë se serbët tani janë të sulmuar dhe duhet të mbrohen, thuhet në raportin e Nismës e cila në fund të korrikut të vitit 2023 kishte thënë se ky është një kërcënim serioz për paqen në Ballkan.

Disa muaj më vonë paraushtarakët serbë sulmuan policinë e Kosovës në veri, kujton raporti, sulmin e 24 shtatorit të vitit 2023 të një grupi serbësh të armatosur që vranë një pjesëtar të Policisë së Kosovës. "Është koha për ta marrë seriozisht atë që po

thuhet aktualisht nga politikanët në Beograd. Nëse shpiken pogrome, atëherë pason dhuna. Nëse këto pretendime të rreme nuk kundërshtohen, situata do të përshkallëzohet më tej", thuhet në raport, në të cilin nënvizohet se "nuk duhet të jetë e vështirë për organizatat ndërkombëtare të hedhin poshtë pretendimet e rreme, mashtruese dhe të rrezikshme për masakrat imagjinare sa herë që ato bëhen. Asnjë nga vëzhguesit e shumtë ndërkombëtarë me personel në terren në Kosovë, nga KFOR-i tek EULEX-i, nga UNMIK-u tek OSBE-ja, nuk ka parë apo përshkruar 'spastrimin etnik të serbëve' apo 'terrorin' shqiptar në

vitet e fundit. Por mungesa e provave nuk i ka ndaluar pretendimet nxitëse".

Nisma thekson se një nga mjetet në këtë betejë të rrëfimeve kanë qenë edhe statistikat. Më 5 tetor 2023 presidenti Vuçiq tha se si pasojë e "terrorit shqiptar", 11 për qind e serbëve të Kosovës janë larguar nga Kosova që nga fillimi i vitit 2021. Më 8 shkurt të vitit 2024, duke folur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Vuçiqi e rriti në "14 për qind" numrin e serbëve të Kosovës që ishin larguar për vetëm një vit, thuhet në raportin prej 18-faqesh në të cilin bëhen krahasime të deklarimeve dhe statistikave të paraqitura nga autoritetet serbe. (Voa)

35-vjetori i grevës së minatorëve të “Trepçës”, kërkohen kushte më të mira të punës

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se rrenjë e shtetndërtimit burojnë nga greva e minatorëve të “Trepçës”. Ai ka pohuar se minatorët u kthyen në vetëdije me guxim politik që dridhi gjithë ish-Jugosllavinë. Në 35-vjetorin e grevës së minatorëve të “Trepçës”, Kurti ka theksuar se përmes grevës e cila zgjati tetë ditë, minatorët kërkuan të drejtat kushtetuese dhe protestuan kundër revokimit të autonomisë së Kosovës të garantuar sipas Kushtetutës së vitit 1974 të Jugosllavisë Socialiste. “Po takohemi sot në ditën e minatorit, në ditën e lavdishme në vendin tonë. 20 shkurti i vitit '99 ishte ditë e madhe e asaj pranvere. Menjëherë pas ditës së pavarësisë, ne nderojmë rrenjë e shtetit tonë. Minatorët porositën qartë se populli ynë nuk heq dorë për të vendosur për veten. Më 20 shkurt të vitit 1989 minatorët u ngujuan për heqjen e autonomisë. Fjala ‘Trepçe’ mori një kuptim të fuqishëm dhe politik, dhe vazhdoi në ditën e fundit. Kështu, një komunitet minatorësh u kthye në vetëdije me guxim politik që dridhi gjithë ish-Jugosllavinë”, ka thënë Kurti. Ai tregoi edhe për investimet që është duke i bërë qeveria në “Trepçe”, të cilën e quajti “pasuri tonë”. “Në gjendje jo të mirë shëndetësore qëndruan mbyllur nëntokë. Minatorët tanë nuk u dorëzuan para së keqes me vendosmërinë e tyre. U përkulemi në nderim përjetë e mot. Në minierë puna jonë është e rëndë, por misioni është i mundshëm. ‘Trepçën’ sot e mbajmë si pasuri tonë duke e qeverisur mirë dhe duke ia rritur vlerën. Suksesi ynë është i



Të dhëna për “Trepçën”

Kompleksi metalurgjik “Trepça” është shoqëri aksionare: 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, 20 për qind janë të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje. Deri në vitet '90, kur është përkeqësuar situata politike, ajo është llogaritur si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në territorin e Jugosllavisë së atëhershme. Në periudhën pas ka nisur rënia e prodhimit dhe zvogëlimi i numrit të punëtorëve, nga rreth 20 000 atëkohë, sot i ka rreth 700 minatorë. Makineritë e vjetruara, mbi 50 vjet dhe mungesa e mirëmbajtjes, janë shndërruar në probleme të vazhdueshme. Greva të punëtorëve, në kërkim të kushteve më të mira dhe pagave më të larta, ka kohë pas kohe.


mundshëm bashkë si qeveri dhe me përkushtimin tuaj”, është shprehur Kurti. Kryeshefi i ndërmarrjes “Trepça”, Bashkim Kurti, ka folur për historikun e kësaj ndërmarrjeje, duke theksuar se daton që nga vetë ekzistimi i Kosovës, për çka kërkoi të jenë unifikues kur bëhet fjalë për “Trepçën”. “Jemi mbledhur sot këtu për të kujtuar grevën e vitit 1989. Minatori i ‘Trepçës’ dje dhe sot vazhdon të dëshmojë për daljen nga sfidat dhe për të na bërë krenar. ‘Trepça’ që nga fillimet e saj, që nga koha romake, ka vendosur themelet e saj dhe ka kaluar në veshitësi. Në

këtë rast nuk mund të mos i përmendim abuzimet që i janë bërë ‘Trepçës’, që janë plagë të paharruara. Minatori është guri i pathyer si gurët e ‘Trepçës’. Kjo reflekton nga vetë qytetarët që u lindën dhe u rritën. Sot në 35-vjetorin e saj të kujtojmë për të mos harruar kurrë djersën dhe mundin për ta ndërtuar shtetin tonë. Festojmë qëndresën dhe përkushtimin për zbatimin e tyre dhe shikojmë kah e ardhmja. ‘Trepça’ është e vjetër aq sa vendi ynë. Të qëndrojmë të bashkuar për ‘Trepçën’”, ka thënë ai. E zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, ka theksuar se

janë në proces të rekrutimit të punëtorëve dhe në hapjen e rrugës për investime të mëdha. “Ne jemi të përkushtuar ta ruajmë ‘Trepçën’ sepse është e jona. ‘Trepça’ është e vetmja që ka një aksionar të dytë. Ndërmarrja po i kthehet minatorit dhe po punon për shtimin e numrit të tyre. Sa më shumë rekrutime të reja. Ndërmarrja po hap rrugën e investimeve të mëdha”, ka deklaruar Mjeku.

Nënkryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, ka thënë

se pikërisht minatorët u bënë motivues të spektrit politik të atëhershëm. Ai kërkoi kushte më të mira të punës për kolegët e tij. “Është një ditë shumë e rëndësishme jo vetëm për ‘Trepçën’, por për gjithë popullin shqiptar. Sot kujtojmë 35-vjetorin e ngjalljes e të motivit. Ishin pikërisht minatorët ata të cilët e motivuan spektrin politik e më pas u rreshtuan krahu UÇK-së duke krijuar fuqinë e madhe. Minatorët kanë nevojë të avancohen me kushte të punës”, ka thënë Tahiri.



Kurti thekson përkushtimin për të ndërtuar një platformë të fortë për dialogun publiko-privat

PRISHTINË, 20 SHKURT - Të martën u mbajt takimi i parë i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, në hapjen e të cilit mori pjesë kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrin e Industrisë, Ndërmarrjes dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, zëvendësministrit Hysen Durmishi dhe Getoar Mjeku, si dhe aktorë të tjerë përfaqësues nga institucionet publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare. Gjatë këtij takimi kryeministri Kurti theksoi përkushtimin për të ndërtuar një platformë të fortë për dialogun publiko-privat, që mundëson identifikimin e mundësive dhe adresimin efikas të sfidave, përmes së cilës edhe është arritur zhvillimi i një plani vjetor ambicioz për vitin 2024 mbështetur nga Sekretariati i pavarur i Këshillit, i financuar nga SECO-ja zvicerane dhe i



menaxhuar nga BERZh-i në Kosovë. “Ky plan përfshin një sërë aktivitete të synuara për t'i nxitur investimet dhe eksportet, si dhe për ta thelluar dialogun ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat. Në këtë plan vjetor janë tri ngjarje kryesore, në tetor dhe në

nëntor 2024, në Kosovë, të cilat ofrojnë mundësi të vlefshme për promovim të investimeve të huaja direkte dhe eksportit, si dhe për të gjitha kombinimet e rrjetëzimit: ‘Qeveri-Qeveri’, ‘Biznes-Qeveri’ dhe ‘Biznes-Biznes’ (B2B)”, u shpreh ai, duke


rrikujtuar datën 3-12 tetor 2024 për shërbimet e mundësuar nga TIK; 24-26 tetor 2024, për Javën e Industrisë së Ushqimit të Kosovës; dhe 20-26 nëntor 2024, për Konventën e Industrisë së Drurit”. Në këtë takim ku u ndanë vizionet

dhe synimet për rrugëtimin e ardhshëm të Kosovës drejt rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm, kryeministri përmendi synimin për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, përkushtimin për një mjedis biznesi lehtësues e inkurajues dhe prioritizimin për reformimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, që ndikon në minimizimin e barrës administrative dhe sigurimin e një mjedisi të barabartë për të gjithë.

Për planin vjetor foli shefi i stafit të kryeministrit Luan Dalipi, i cili tha se qasja e qeverisë ndaj bashkëpunimit me sektorin privat ka qenë dhe është e bazuar në tri shtylla kryesore: vlera, sisteme dhe rezultate.

Në bashkëpunim me Sekretariatën e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, ai tha se është definuar qartë një kalendar për tërë vitin si dhe për vitet e ardhshme të dialogimit publiko-privat.

A kemi krijuar një shoqëri shumë komplekse për të mbijetuar?



Shoqëritë njerëzore evoluojnë nga format e thjeshta, në ato komplekse gjatë mijëvjeçarëve, duke përjetuar ndryshime të ngadalta deri në shekujt e fundit, kur teknologjia përshpejtoi evolucionin tonë. Gjatë dy shekujve të fundit, përparimet teknologjike e kanë transformuar shoqërinë me një ritëm të paparë. Adam Frank eksploron se si ky ritëm gjithnjë e më i shpejtë i evolucionit tekno-social ngre pyetje në lidhje me aftësinë e njerëzimit për t'u përshtatur

Homo sapiens evoluoi si një specie e veçantë rreth 300,000 vjet më parë. E matur në breza (ku çdo brez zgjat 20 vjet), kjo do të thotë se janë rreth 15,000 stërvjetë gjyshër që na ndajnë nga paraardhësit më të hershëm njerëzorë. E ndërsa ky është një fakt interesant në vetvete, ajo që është me të vërtetë e jashtëzakonshme është se si bota ku jetojmë secili prej atyre brezave ishte jashtëzakonisht statike. Natyrisht, ka pasur fatkeqësi natyrore dhe luftëra. Megjithatë, në përgjithësi, universi "tekno-social" ku jetojmë stërgjyshi juaj i 9045-të nuk ishte shumë i ndryshëm nga ai ku banonte i 9046-të. E njëjta gjë vlen edhe për shumicën dërrmuese të brezave pas tyre.

Por kjo gjendje statike brez pas brezi nuk është aspak ajo që përjetojmë ne dhe shumica e njerëzve në planet sot. Ne jetojmë në një botë ndryshimesh të shpejta të nxitura nga

teknologjia që ka prodhuar një botë tekno-sociale me kompleksitet marramendës. Është një situatë krejtësisht e ndryshme nga pothuajse çdo brez tjetër në linjën njerëzore. A është ky një problem? A kemi krijuar një botë që është shumë komplekse dhe që ndryshon shpejt për të mirën tonë?

Një eksperiment i paprecedentë

Harku i kulturave njerëzore, në përgjithësi, ka nisur nga grupet më të vogla të gjuetarëve-mbledhësve në vendbanime më të mëdha dhe më komplekse. Historia që tregohet shpesh është ajo ku kalimi në bujqësi dhe zbutje të kafshëve rreth 9000 vjet më parë, i shtyu njerëzit të krijonin shoqëri sedentare. Këto u rritën në madhësi së bashku me rendimentet ushqimore që lejonin kultivimi dhe blegtoaria. Në këtë mënyrë, fshatrat u

shndërruan në qyteza, qytezat në qytete dhe qytetet në perandori. Ndërsa disa aspekte të kësaj historie – si roli i bujqësisë – tani debatohen më fort, është e qartë se shoqëritë njerëzore janë rritur në madhësi dhe në kompleksitet.

Kompleksiteti mund të matet në shumë mënyra, por një nga më të frytshmet është ta mendosh një shoqëri, si një rrjet marrëdhëniesh. Duke përdorur mjetet e shkencës së rrjeteve, është e mundur të përcaktohet ajo që quhet "topologjia" e rrjetit. Një rrjet ku çdo person ka një lidhje me të gjithë të tjerët duket shumë i ndryshëm nga ai ku çdo person njih vetëm disa njerëz, që gjithashtu njohin disa njerëz e kështu me radhë. Dhe, për të përdorur një shembull ekstrem, të dyja këto topologji rrjetesh janë të ndryshme nga ajo ku të gjithë njohin vetëm një individ të veçantë dhe shumë qendror.

Kur ne ishim gjuetarë-mbledhës në fise të vogla, jetonim në llojin e rrjetit "të gjithë i njohin të gjithë". Por teksa shoqëritë u bënë më të mëdha, topologjitë ndryshuan. Kishte ende rrjete sociale lokale, por këto u futën në rrjete më të mëdha marrëdhëniesh që trajtonin gjithçka, nga administrata qeveritare te tregtia (mendoni Romën Perandorake ose Dinastinë Song në Kinë). Por ndërsa këto rrjete "civilizuese" ishin më komplekse se ato që njerëzit popullonin 100,000 vjet më parë, ritmi i ndryshimit ishte ende i ngadaltë.

Rregullat e rrjetit social ndryshuan ngadalë: Shumica e brezave nuk panë ndryshime rrënjësore shoqërore gjatë jetës së tyre, përveç nëse vinte ndonjë ushtri pushtuese, e madje edhe atëherë, rregullat e rendit shoqëror (d.m.th. rrjetet sociale) mund të mos kenë ndryshuar shumë.

Evolucioni tekno-social

Megjithatë, në botën që kemi ndërtuar gjatë shekullit të kaluar, ritmi i ndryshimeve të rëndësishme teknologjike dhe sociale ka ndodhur brenda fraksioneve të një jete të vetme njerëzore. Mendoni se sa përsëritje të telefonit keni parë. Në moshën 61-vjeçare, më kujtohet kur telefonat lidheshin me kablo me një mur. Tani, teknologjia përparon aq shpejt sa të gjithë jemi të detyruar të blejmë një telefon të ri çdo 2-3 vjet, sepse të vjetrit thjesht nuk mund të vazhdojnë më.

Videot e spikatura

Ndërsa telefonat janë thjesht një aspekt i rrjeteve tona teknologjike, ne mund të përdorim ata, për të parë ndikimin e teknologjisë në organizimin shoqëror. Nuk ka nevojë t'ju tregoj se sa thellësisht mediat sociale dhe platformat e tjera dixhitale kanë ribërë normat sociale dhe politike. Nga aplikacionet e takimeve te përhapja e shpejtë e

dezinformatave politike, pritshmëritë për mënyrën se si njerëzit mund ose duhet të sillen kanë ndryshuar, dhe më pas janë ndryshuar përsëri në një shkallë kohore që tani është më pak se sa një dekadë.

Pika thelbësore për t'u kuptuar kur merren parasysh këto ndryshime është se çdo sistem ka afate kohore të natyrshme për ndryshimin e integruar. Këto afate kohore bazohen në "ligjet" e sistemit, rregullat e tij të brendshme. Nëse sistemi është një grumbull planetësh që rrotullohen rreth një ylli, atëherë ligjet janë ato të gravitetit dhe momentit këndor. Nëse sistemi është një rrjet ushqimor në një pellg, atëherë afati kohor mund të bazohet në atë se sa kohë duhet që uji të rrjedhë nga një skaj në tjetrin. Ajo që ka rëndësi këtu është se nëse sistemi përjeton ndryshime gjatë një periudhe që është më e gjatë se, ose afërsisht sa, afati kohor i brendshëm i sistemit, atëherë ai sistem zakonisht mund të përshtatet. Ai nuk do të shpërthejë ose do të shpërbëhet në përgjigje të këtyre ndryshimeve. Por nëse ndryshimet janë vërtet të forta dhe ato ndodhin shumë shpejt në krahasim me afatet kohore të sistemit, mund të ndodhin gjëra të këqija.

Pra, cili është afati kohor i natyrshëm për rrjetet që përbëjnë botën tonë tekno-sociale njerëzore? Kjo është pyetja një milionë dollarëshe. Përgjigja naive: afërsisht një jetë njerëzore (d.m.th. një shekull apo më shumë). Pati shumë ndryshime nga viti 1820 në 1920, por shoqëria nuk u shpërbë. Kjo mund të ketë të bëjë me fleksibilitetin e njohjes njerëzore dhe natyrën e rrjeteve sociale (topologjinë e tyre) që i mbajnë shoqëritë të qëndrueshme.

Por tani kemi ndryshime të forta në afate kohore që janë më pak se një gjeneratë e vetme. A është kjo shumë e shpejtë për njohjen e shpërndarë që ndodh në rrjetet tona sociale dhe politike? A është ritmi i ndryshimit teknologjik – i shoqëruar me ndikimin që ato ndryshime kanë në organizimin shoqëror (d.m.th. rregullat e rrjetit) – tani shumë i shpejtë për t'u përthithur nga sistemet tona? Kjo është gjithashtu pyetja miliona dollarëshe.

Megjithatë, një gjë është e sigurt. Të gjithë brezat që jetojnë sot janë pjesë e një eksperimenti të gjerë e të paplanifikuar në fleksibilitetin dhe stabilitetin e rendit shoqëror njerëzor. Fati ynë si specie planetare varet nga mënyra se si do të shkojë ai eksperiment.

Big Think – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sot tri ndeshje në Superligë, vëmendja në derbin Drita - Ballkani

PRISHTINË, 20 SHKURT - Sot (e mërkurë) dhe nesër (e enjte) do të zhvillohet xhironja e 21-të në Superligën e futbollit. Vëmendja do të jetë në derbin në mes të Dritës dhe

Ballkanit, pasi të dyja këto klube janë në garë për titullin e kampionit. Kampionët e Ballkanit janë liderë në tabelë me 44 pikë, shtatë më shumë se të kaltrit

nga Gjilani që janë të tretit. Të mërkurën zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera. Prishtina do të përballlet me Malishevën, kurse Feronikeli 74 me Gjilanin. Ndërkohë, Llapi e

kërkon fitoren e pestë radhazi në ndeshjen në udhëtim ndaj Fushë-Kosovës. Dukagjini - Liria do të jetë ndeshja e fundit e kësaj xhironje dhe zhvillohet të enjten.



Kuvendi i FFK-së, miratohen Raporti i Punës dhe ai Financiar

"Epoka e re"

PRISHTINË, 20 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka mbajtur Kuvendin e Rregullt të Punës nën drejtimin e presidentit Agim Ademi. Në këtë kuvend është miratuar buxheti për vitin 2024. Ky buxhet do të ketë një rritje prej një milion euro më shumë krahasuar me vitin e kaluar, pra do të jetë 20 milionë e 970 mijë e 566 euro.

Drejtori i financave në FFK, Agim Gashi, zbuloi se të hyrat vijnë nga kontrata me sponsorë, nga UEFA dhe FIFA dhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky projektbuxhet u miratua nga të gjithë delegatët në Kuvendin e Punës së Federatës së Futbollit të Kosovës. Gashi ka zbuluar të gjitha shpenzimet e FFK-së dhe të hyrat që janë në shtëpinë më të madhe të futbollit të Kosovës. Shpenzimet më të mëdha FFK i ka në pagat, pasi në vitin 2023 për paga u shpenzuan 4 milionë e 53 mijë e

325 euro nga 25 sektorë apo njësi që kompensohet nga FFK, duke filluar nga administrata, ekipet nacionale, administrata e lidhjeve rajonale, gjyqtarët e të gjitha ligave, ekipet e femrave, gjyqtarët dhe zyrtarët e futbollit, ekipi u21. Trajnerët e të gjitha grupmohave, delegatët, ligat e femrave, futbollit, liga e veteraneve dhe u21 që janë paguar nga ky buxhet. Po ashtu, janë miratuar edhe procesverbali i Kuvendit të kaluar, si dhe propozimi i KE të FFK-së për anëtarët e Komisionit Zgjedhor dhe organeve gjyqësore si dhe Kodi Zgjedhor. Të pranishëm ishin përfaqësuesit e FIFA-s, Lorenzo Cavallari e Gianni Manco, përfaqësuesi i UEFA-s, Denis Bastari, presidenti i Federatës së Futbollit të Maqedonisë së Veriut, Muamed Sejdiu, zv/presidenti i FSHF-së, Lutfi Nuri dhe sekretari i përgjithshëm Ilir Shulku, si përfaqësues të Ministrisë së Sportit dhe të KOK-ut.

Presidenti Ademi falënderoi delegatët për mbështetjen që po i



japin zhvillimit të futbollit si dhe mysafirët e pranishëm për përkrahjen dhe partneritetin me FFK-në. Ai më pas bëri një shpalosje të gjerë të punës së bërë gjatë vitit 2023, duke filluar nga masivizimi i futbollit në vend, përmirësimi i infrastrukturës, ngritja e cilësisë së garave, si dhe realizimi i projekteve

gjithëpërfshirëse në futboll. "Gjithmonë së bashku me KE të FFK-së jemi të qasshëm për ju dhe do t'ju ofrojmë mbështetjen e nevojshme. Ju jeni ata që ju përgjigjem dhe ju jap llogari. Në momentin që ju e shihni që Agim Ademi nuk ka çfarë t'i japë futbollit, besoni se do të largohesha dhe do t'ju thosha

faleminderit, por gjithsesi ta kemi gjithmonë në mendje të gjithë se FFK-në duhet ta udhëheqë dikush i futbollit dhe që ka kontribuar për futboll", ka thënë Ademi. "Uroj të vazhdoj kështu dhe të kemi sa më shumë të mira për futbollin e sa më shumë rezultate. Misioni i FIFA-s e UEFA-s është se futboli bashkon botën, e lëre me një bashkim të një federate. Ju falënderoj për gjithçka që keni bërë për futbollin dhe për besimin", ka shtuar Ademi.

Ibër Alaj nga Ministria e Sportit premtoi se kjo ministri, së bashku me autoritetet lokale, do t'i qëndrojë afër FFK-së për përmirësimin e infrastrukturës së stadioneve dhe krijimit të kushteve më të mira për zhvillim të futbollit.

Fjalë të mira për punën e FFK-së patën edhe përfaqësuesi i FIFA-s, Lorenzo Cavallari, përfaqësuesi i UEFA-s, Denis Bastari, presidenti i FFK-së, Muamed Sejdiu dhe zëvendëspresidenti i FSHF-së, Lutfi Nuri.



Rohde: Emërimi i Fodas thekson marrëdhëniet e veçanta Kosovë - Gjermani

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ditë më parë Përfaqësuesja e Kosovës është bërë me trajner të ri. Në krye të saj erdhi gjermani Franco Foda. Trajneri gjerman u paraqit te "dardanët" në ditën e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn

Rohde, i ka thënë disa fjalë në lidhje me emërimin e Fodas te Kosova, në llogarinë e tij në "Twitter". Rohde u shpreh shumë i lumtur që Foda do ta drejtojë ekipin e Kosovës. "Lajm i mrekullueshëm pikërisht në kohën e Ditës së Pavarësisë fundjavën e kaluar: I kënaqur që

Franco Foda merr drejtimin e ekipit kombëtar të Kosovës në futboll. I uroj atij dhe gjithë ekipit të tij suksese të mëdha. Veprimi i FFK-së, sekretarit gjeneral Weidner dhe trajnerit Foda tregojnë fuqishëm marrëdhëniet tona të veçanta, gjithashtu edhe në futboll".

Bajrami largohet nga Ulpiana

LIPJAN, 20 SHKURT - Trajneri Emin Bajrami është larguar nga KF Ulpiana 1926. Klubi nga Lipjani ka njoftuar se trajneri i njohur ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij qysh në start të pjesës së dytë të sezonit. Ulpiana e ka

falënderuar trajnerin për punën e bërë për një vit e gjysmë dhe i ka uruar suksese. Ky klub pretit ta zyrtarizojë shumë shpejt trajnerin e ri. "Të nderuar tifozë, KF Ulpiana 1926 ju njofton se pas një periudhe më shumë se 1 vit e

gjysmë në krye të shtabit teknik, Emin Bajrami ka ofruar dorëheqje nga pozita e trajnerit. Me këtë rast, KF Ulpiana 1926 e falënderon për zëmërisht trajnerin Bajrami për punën dhe kontributin e tij sa ishte pjesë e

klubit tonë, duke i dëshiruar shumë suksese në të ardhmen", thuhet në njoftimin e kësaj skuadre. Ulpiana gjendet në pozitën e katërt në Grupin B të Ligës së Parë me 31 pikë, vetëm tri më pak se liderja, Vjosa.



Lakersat sigurojnë yllin e Brooklynit, synojnë edhe talentin e Atlantas

LOS ANXHELOS, 20 SHKURT - Skuadra e Lakersave po bën një merkato të fuqishme këtë periudhë, për të ndërtuar një ekip të fortë dhe që mund të pretendojë për titullin kampion në NBA. Për momentin ekipi kalifornian është në zonën

“play-out” në Konferencën e Perëndimit, zonë ku ishte edhe vjet e më pas shkoi deri në finalët e kësaj Konference. Së fundi, lakersat kanë siguruar basketbollistin 30-vjeçar Spencer Dinwiddie, që erdhi nga Brooklyn. Një basketbollist me

përvojë, që ka luajtur me disa skuadra në NBA dhe që do t'u japë më shumë forcë lakersave. Por kalifornianët nuk do të ndalen këtu, pasi objektivi kryesor është ai i transferimit të organizatorit Trae Young, që luan me Atlantian. Ai pritet të jetë ylli i

tretë i ekipit, por nuk dihet nëse transferimi mund të kryhet që në shkurt apo verën e ardhshme. Pas ndeshjes së “All Star Game”, kampionati për momentin është disa ditë pushim dhe skuadrat janë duke kryer disa manovra në merkato.



Publikohet lista e Përfaqësueses U18, synohet kualifikimi në Botëror

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kryetrajneri i Përfaqësueses U18, Mitat Ferati, ka publikuar të martën listën e lojtarëve të ftuara në grumbullimin për kampionatin IHF Trophy Intercontinental, që prej 28 shkurtit deri më 3 mars mbahet në Tashkent të Uzbekistanit. Në listën e gjerë janë 17 lojtare, ndërsa 14 prej tyre udhëtojnë për në Uzbekistan. Grumbullimi i Përfaqësueses U18 do të bëhet të mërkurën (21 shkurt) në Prishtinë. Përfaqësuesja do të ushtrojë në Kosovë deri më 26 shkurt, kur është udhëtimi për në Uzbekistan. IHF Trophy Intercontinental është ngjarje kualifikuese për Kampionatin Botëror U18 që mbahet në verë. Kualifikimi në Botëror është synimi i Përfaqësueses së Kosovës. Kosova U18 është në grup me Guatemalën dhe Uzbekistanin. Në grupin tjetër janë Guadalupe, Kaledonia e Re dhe Nigeri. Më 29 shkurt Kosova luan me Uzbekistanin. Më 1 mars është ndeshja me Guatemalën. Më 2 mars janë ndeshjet gjysmëfinale dhe ndeshja për vend të pestë.



Ndërsa ndeshja për vend të tretë dhe finalja janë më 3 mars. Të kujtojmë që hendbollistët tanë të grupmoshës U21 kanë shkruar histori duke u kualifikuar në Kampionatin Botëror të mbajtur në Spanjë. Një sukses të tillë e synojnë edhe hendbollistët e reja. Ato vjet e fituan vendin e parë në IHF Trophy për zonën evropiane dhe kështu u kualifikua për fazën ndërkontinentale.

Lista e lojtarëve

Diona Dresh, Andra Uglani, Daorsa Bici, Orgesa Gola, Arjeta Imeraj, Arona Krasniqi, Albina Pllana, Jurosana Haskaj, Melisa Hoxha, Bulëza Maksuti, Verona Hasani, Rita Esrefi, Eliona Halimi, Sara Gjergjaj, Zoja Kameraj, Laura Maqedonci, Alina Shabani.

Sainz: Dua ta mbyll mirë vitin e fundit te Ferrari



MADRID, 20 SHKURT - Piloti spanjoll i Ferrarit, Carlos Sainz, nuk e ka vendosur ende destinacionin e tij për vitin 2025, gjë që do të ndodhë pas disa muajsh. Ai do t'i lë vendin Lewis Hamiltonit, që do të vijë te “kokëkuqja” në fund të këtij viti. “Nuk e di ende ekipin tim të

ardhshëm. Kam pak kohë për të vendosur se cili është”, ka thënë Sainz. “Kam shumë opsione. Këtë vendim do ta marrim në muajt në vijim. Mendoj se kam thënë se doja të rregulloja të ardhmen time para garës së parë, por tani skenari ka ndryshuar shumë, siç mund ta

imagjinoj”, u shpreh Sainz në sezonin e tij të fundit me Ferrarin. “Procesi do të jetë më i gjatë, por mund të jem i sigurt se kur të marr vendimin do t'i kem dhënë vetes kohë dhe informacion të mjaftueshëm. A mund të ndikojnë diskutimet për ekipin e ri në punën në pistë? Besoj se është e pamundur të ndaj një gjë nga tjetra, por synimi im tani e tutje do të jetë të bëj mirë testet në Bahrein, pa menaxhuar sezonin”, ka përfunduar Sainz. Spanjollit do të kishte pëlqyer të kishte një situatë më të përcaktuar kontraktuale në fillim të sezonit para se t'i niste testimet. Sainz nuk ngutet, sepse e di mirë që është një nga pilotët më të vlefshëm në treg. Në gjurmët e tij janë Mercedes dhe Sauber/Stake (me një dritare të qartë në Audi më 2026), por edhe Aston Martin nëse Fernando Alonso do të largohej.

SHKURT

Krasniqi dhe Ajeti në formacionin e javës në Rumani

Federata e Futbollit e Rumanisë ka bërë publike formacionin më të mirë të xhiros së 26-të. Pjesë e këtij formacioni janë dyshja shqiptare Ermal Krasniqi e Arlind Ajeti. Krasniqi pati super paraqitje për skuadrën e tij të Rapid Bukureshtit në fitoren ndaj Hermannstadt me rezultatin 2-0. Futbollisti kosovar realizoi gol dhe dha një asistim në këtë ndeshje. Kjo paraqitje e tij ka bërë që ai të zë vend në formacionin e javës. E aty gjendet edhe futbollisti tjetër shqiptar, Arlind Ajeti, i cili paraqitet për Clujin. Ajeti me Clujin arritën fitore në udhëtim te Craiovas me rezultatin 1-3. Përfaqësuesi i Kombëtares shqiptare nuk shënoi, por pati paraqitje tejet të mirë në fazën e mbrojtjes. 11-shën më të mirë e dominon ekipi i Dinamo Bukureshtit me tre futbollistë, derisa nga dy përfaqësues kanë Cluji dhe Arad.

Futbolli gjerman në zi, ndahet nga jeta Andreas Brehme

Futbolli gjerman është në zi teksa gjatë natës është ndarë nga jeta ish-futbollisti Andreas Brehme. Heroi i Gjermanisë Perëndimore në Kupën e Botës së vitit 1990 u nda nga jeta në moshën 63-vjeçare si pasojë e një arresti kardial. Mediet gjermane zbulojnë se Brehme u dërgua në spital, por nuk mundi t'i mbijetonte sulmit në zemër. Kujtojmë se kjo humbje e madhe për futbollin gjerman vjen një muaj pas ndarjes nga jeta edhe të legendës Franz Beckenbauer, i cili ishte mentori i Brehmes. Brehme shënoi golin vendimtar për Gjermaninë në finalen e Kupës së Botës në Romë përballë Argentinës teksa realizoi në minutën e 85 nga penalltia.

Zidane në verë mund ta marrë drejtimin e Bayernit

Bayern Muncheni në sezonin e ardhshëm do të ketë një trajner të ri. Sipas “Sky Deutschland”, emri më i fundit është ai i francezit Zinedine Zidane, me të cilin klubi ka pasur disa kontakte. Klubi ka konfirmuar për momentin trajnerin Thomas Tuchel pavarësisht prej vështirësive në kampionat dhe në Ligën e Kampionëve. Gjithsesi, drejtuesit nuk duan të kapen të papërgatitur nëse situata përkeqësohet. Zidane, 51 vjeç, nuk drejton një skuadër që nga vera e vitit 2021, pasi përfundoi kontratën te Real Madridi. Pikërisht për këtë arsye do ta kishte avantazhin që të mund të merrte menjëherë skuadrën. “Bavarezët” vijnë pas tri humbjeve radhazi, dy në Bundesligë dhe një në Ligën e Kampionëve. Kandidatët për ta zëvendësuar Tuchelin janë edhe Alonso, Flick e Conte.

Chelsea shpreh interesim për transferimin e Kanes

Chelsea po konsideron një lëvizje shokuese për Harry Kanen këtë verë pasi Bayern Munchen vazhdon të lëkundet nën drejtimin e Thomas Tuchelit. “Bavarezët” rëshqitën më tej pas Bayer Leverkusenit në garën për titull në Bundesligë pasi humbën 3-2 ndaj Bochumit dhe tani janë tetë pikë prapa liderëve të Xabi Alonsos. Pavarësisht se Kane shënoi golin e tij të 25-të të sezonit në ligë, nuk ishte e mjaftueshme për t'i rikthyer kampionët gjermanë në rrugën e dhur dhe ata tani kanë humbur tri ndeshje radhazi në të gjitha garat. Kane shënoi 278 gola gjatë kohës së tij në Londrën e Veriut, duke u bërë golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve të “Spurs”-u dhe duke thyer zemrat kur njoftoi largimin e tij verën e kaluar. Kalimi në Chelsea do ta shihte atë të ribashkohej me një nga ish-menaxherët e tij, Mauricio Pochettino.

Agjenti i Mottas: Vështirë të refuzohen klubet si PSG-ja, Milani dhe Juve

Bologna e drejtuar nga trajneri Thiago Motta po mahnit të gjithë futbolldashësit në Itali dhe jo vetëm. Skuadra e teknikut italo-brazilian është aktualisht në vendin e pestë dhe po lufton

për të siguruar një biletë për në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Në Serinë A, Milani dhe Juventus janë dy nga klubet që janë të “joshura” nga Motta teksa agjenti i trajnerit të

Bolognas, Dario Canovi, pranoi se i përfaqësuar i tij kërkohet nga më të mirët. “Motta është nga ata trajnerë që tërhiqen pas një projekti, kërkon të marrë pjesë në ndërtimin e skuadrës

dhe të jetë i përfshirë në zgjedhjet e klubit. Nuk besoj se në të ardhmen do të pranoj një klub që i ofron vetëm një skuadër të mirë. PSG, Juve apo Milan? Bëhet fjalë për klube të

mëdha. Do të jetë e vështirë për të refuzuar klube kaq prestigjioze. Raporti me Ibrën? Në Paris u bënë shumë miq dhe ka shumë respekt mes tyre”, u shpreh Canovi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 20.02.2024 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-24-2

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça SH.A.
Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapsirave në objektet e Fabrikës së Paisjes së Procesit (FPP)

1. Depoja e Bombolave në FPP - Siperfaqja e mbuluar 227.78 m²
2. Reparti i vjetër në FPP - Siperfaqja e mbuluar 182 m²
3. Depoja numer 2 në FPP - Siperfaqja e mbuluar 280 m²
4. Depoja numer 1 në FPP - Siperfaqja e mbuluar 500 m², siperfaqja e pambuluar 207 m²
5. Depoja e repromaterialeve në FPP - Siperfaqja e mbuluar 70 m²

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë

Data e shpalljes: 20.02.2024

Sqarimi: deri me 07.03.2024

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 07.03.2024

Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizionit i shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 07.03.2024 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës te pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madhe apo i barabarte me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1

OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T?)	

Përmbledhje		Çmimi
a	m ²	
b	Çmimi për metër	
c = a * b	Çmimi me TVSH	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund te behet deri me datën 07.03.2024 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim

T -24 2

Nr. identifikues	Titulli i Kontratë	Sipërfaqja [m ²] e mbuluar	Sipërfaqja [m ²] e pambuluar
Loti 1	Depoja e Bombolave	227.78 m ²	0.00 m ²
Loti 2	Reparti i vjetër në FPP	182.00 m ²	0.00 m ²
Loti 3	Depoja numer 2	280.00 m ²	0.00 m ²
Loti 4	Depoja numer 1	500.00 m ²	207.00 m ²
Loti 5	Depoja e repromaterialeve	400.00 m ²	0.00 m ²



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sirja Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme Diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Valdrin Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Saranda Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Mjekësisë, "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Halil Malsori nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Enea Memia, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Vegim Hamza, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Albulena Ethemi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterinikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

